

VENDIM
Nr. 149, datë 10.6.2022

MBI KËRKESËN PËR LICENCIM TË SHOQËRISË “SALILLARI ENERGY TRADE” SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.6.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 866/12 prot., datë 2.6.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Salillari Energy Trade’ sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 90, datë 28.4.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Salillari Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5- vjeçar.

- ERE, me shkresën nr. 70/15 prot., datë 29.4.2022, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 16.5.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ndërsa me shkresën nr. 469/2 prot., datë 6.5.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “Salillari Energy Trade” sh.p.k., me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 469/5 prot., datë 20.5.2022 dhe nr. 495/6 prot., datë 24.5.2022, ka përcjellë në ERE dokumentacionin dhe informacionin shtesë.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë për furnizimin e energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Në mbështetje të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me qëllim dokumentimin dhe depozitimin në ERE të vërtetimit të prokurorisë për administratorin e saj dhe dokumentacionin që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, vlerësohet e arsyeshme që shoqëria “Salillari Energy Trade” sh.p.k. të paraqesë në ERE, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pune, dokumentet e kërkuara në përputhje me rregulloren në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shoqëria “Salillari Energy Trade” sh.p.k. të paraqesë, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pune, dokumentet e kërkuara në përputhje me rregulloren në fuqi.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti